



PROCESVERBAL

i Mbledhjes së Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës

Sot, më 18.02.2026, duke filluar nga ora 16:30, në përputhje me thirrjen e datës 12.02.2026 mbështetur në vendimin Nr. 06-BD/2026 të dates 11.02.2026, dhe në pajtim me Statutin, vazhdoi mbledhja e Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës e cila ishte hapur me datën 07.02.2025 por nuk kishte vazhduar si shkak i mungesës së kourumit. Mbledhja vazhdoi me të njëjtat pika të rendit të ditës.

Kryetari, me rastin e hapjes së mbledhjes, përshëndeti anëtarët e Kuvendit, Bordin Drejtues, Komisionin Disiplinor dhe të Ankesave, përfaqësuesit e Komisionit Mbikëqyrës, si dhe mysafirët e pranishëm, duke i falënderuar për pjesëmarrjen. Ai uroi mirëseardhje në vazhdimin e punimeve të Kuvendit të II-të të rregullt të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, të cilat po vazhdojnë sot më 18 shkurt 2026, në Hotel Emerald.

Kryetari shprehu falënderim të veçantë për sponsorin e organizimit, kompaninë Construmax Sh.P.K., sponsor logjistik i Kuvendit të Rregullt Vjetor të OIRK-së, si dhe inkurajoi kompanitë dhe partnerët e tjerë që të mbështesin Odën në forcimin dhe zhvillimin e saj, me qëllim të ngritjes së standardeve profesionale në Kosovë.

Kryetari caktoi procesmbajtëse të mbledhjes znj. Leonora Muçaj, zyrtare e administratës së OIRK-së.

Para fillimit të punimeve, Kryetari kërkoi nga administrata të konstatohet kuorumi i nevojshëm për vazhdimin e mbledhjes. Gjatë evidentimit të pjesëmarrjes Kryetari informoi anëtarët e Kuvendit se numri i anëtarëve të Kuvendit me anëtarësi të rregulluar dhe me status aktiv është 847. Në mbështetje të nenit 17 të Statutit, Kuvendi ka kuorum kur në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Odës, ndërsa sipas nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, Kuvendi i Odës përbëhet nga anëtarët e licencuar të Odës, me përjashtim të periudhës së përkohshme të themelimit të Odës, ku anëtarët e Kuvendit janë anëtarët themelues të Odës, që dmth, në sallë duhet të jenë minimum 424 anëtarë themelues për të vazhduar punimet Kuvendi.

Pas evidentimit, u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm 512 anëtarë, me ç'rast u konstatua kuorumi për të vazhduar me punimet e Kuvendit.

Pika 1 – Miratimi i rendit të ditës

Në fillim Kryetari sqaroi se mënyra e votimit do jetë me ngritje dore, do të votohet për, kundër apo apstenim.

Më pastaj Kryetari e hodhi në votim rendin e ditës:
me 512 vota Për,
0 vota Kundër dhe
0 vota Apstenim

Miratohet rendi i ditës.

Pika 2 – Mbledhja e parë e Kuvendit të OIRK-së pas themelimit, informim të shkurt për procesin e themelimit

Kryetari prezantoi informacione hyrëse lidhur me dokumentet e miratura në Kuvendin e I-rë themelues të dates 21 dhjetor 2024, siq janë Statuti dhe 10 rregulloret e tjera të Odës të cilat gjinden në Webfaqen e Odës. Gjithashtu Kryetari informoi se në atë mbledhje janë zgjedhur organet drejtuese të Odës, Bordi Drejtues dhe Komsioni Disiplinor dhe ai i Ankesave, mandej Bordi drejtues ka zgjedhur Kryetarin.

Pika 3 – Raporti vjetor i punës së Odës për vitin 2025

Kryetari prezantoi raportin vjetor të punës së Odës për periudhën janar–dhjetor 2025. Pas prezentimit Kryetari kërkoi nga anëtarët nëse ka pyetje për diktatime rreth raportit vjetor. Nuk pati pyetje, kështu që Kryetari kërkoi nga administrata që të konstatoj numrin e anëtarëve prezent.

U konstatua se numri i anëtarëve prezent në Kuvend ishte 512.

Pas konstatimit të anëtarëve prezent, Kryetari e hodhi në votim Raportin vjetor të punës.

me 511 vota Për,
0 vota Kundër dhe
1 votë Apstenim

Miratohet raporti vjetor i punës së Odës për vitin 2025

Pika 6 – Shqyrtimi dhe miratimi i dy rregulloreve të Odës

Kryetari e ftoi Anëtarin e Bordit Drejtues znj. Mimoza Shahini që ta prezantoj Rregulloren e Punës së Kuvendit të Odës së Inxhinirëve të Republikës së Kosovës. Pas prezantimit, Kryetari e falënderoi për prezantimin thelbësor të rregullores.

Më pas, e ftoi Anëtarin e Bordit Drejtues, z. Bujar Jupaj, që ta prezantoj Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Administratës së Odës së Inxhinirëve të Republikës së Kosovës. Pas prezantimit, Kryetari e falënderoi për prezantimin thelbësor të rregullores, dhe më pastaj kërkoi nga administrata që të konstatoj numrin e anëtarëve prezent.

U konstatua se numri anëtarëve prezent në Kuvend ishte 545.

Pas konstatimit të anëtarëve prezent, Kryetari i hodhi në votim në pako këto dy rregullove.

me 545 vota Për,
0 vota Kundër dhe
0 vota Apstenim

Miratohet Rregullorja e Punës së Kuvendit të Odës së Inxhinirëve të Republikës së Kosovës dhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të Administratës së Odës së Inxhinirëve të Republikës së Kosovës.

Pika 7. Shqyrtimi dhe miratimi i “Projekt Rezolutës për miratimin e dokumenteve referuese për kategorizimin e ndërtimit, çmimin mesatar të ndërtimit dhe çmimet minimale referuese të shërbimeve arkitektonike dhe inxhinierike”.

Kryetari prezantoi punën e grupeve punuese lidhur me hartimin e rezolutës (Çmimore), punën e Bordin drejtues, bashkëpunimin me grupin punues dhe Bordin e Odës së Arkitektëve, me qëllim që të vendosen hapat e parë për një dokumenti të tillë që i mungon Republikës së Kosovës.

Më pas, kryetari e ftoi Anëtarin e Bordit Drejtues z. Afrim Demiri që ta prezantoj Projekt - Rezolutën.

Në fillim z.demiri sqaroi se pse ky document është quajtur rezolutë, duke theksuar se ligji i Odave nuk na jep mundësinë që një dokument të tillë ta quajm Rregullore, derisa Rezoluta është e lejuar me statut andaj në këtë fazë do kërkohet të miratohet si rezolutë e pas ndryshimeve ligjore do të punohet të bëhet rregullore.

Pas prezantimit të Projekt - Rezolutës, Kryetari kërkoi pyetje dhe diktume nga anëtarët.

- I pari e morri fjalën anëtari z. Idriz Shala i cili parashtrroi pyetje lidhur me vlerën e çmimit mesatar, çmimeve minimale, duke theksuar se sipas tij këto çmime u referohen kompanive dhe jo inxhinierëve si individë, mënyrën e tenderimit si dhe ngriti çështjen e ndarjes së odave në përputhje me ligjin konkretisht pse most ë bëhet document i pavarur nga Oda e Arkitektëve.

Kryetari dha sqarime përkatëse duke theksuar se grupet punues por edhe Bordi Drejtues kanë analizuar modele të ndryshme të shteteve fqinjë por edhe Evropiane për marrjen e mostrave, nga këto modele për nxjerrjen e çmimoreve minimale për shërbime inxhinierike dhe arkitektonike shihet që janë marrë për bazë çmimet mesatare referuese të ndërtimit. Kryetari gjithashtu sqaroi që kjo Rezolutë nuk është përfundimtare por ajo do plotësohet gjatë vitit 2026, e gjithashtu do të bëhet ndarja e përqindjeve të secilit pjesëmarrës profesionit në projekt, duke theksua që Oda sipas ligjit i mbron të drejtat e inxhinierëve dhe jo kompanive. Derisa për bashkëpunimin me Odën e Arkitektëve, Kryetari theksoi domosdoshmërinë pasi jemi nën ombrellën dhe një document të tillë ka vullnet që bashkërisht ta harmonizojmë. Në fund Kryetari e falenderoi për pyetjen z.shala dhe i kërkoi bashkëpunim me organet e Odës në plotësimin e këtij dokumenti gjatë vitit 2026.

- Z. Lutfi Gashi parashtroi pyetje lidhur me relacionin ndërmjet inxhinierëve dhe kompanive dhe klasifikimin e kompanive në projekte.

Kryetari i dha fjalën Abëtari i Bordit z. Nebi Pllana për përgjigje. Pllanba sqaroi se Oda merret me inxhinierët si individë dhe jo me kompanitë, duke theksuar që organet e Odës do të mbrojnë intersat e inxhinierëve në çdo rrethanë nëse ato shkelen.

- Z. Shiqeri Dermaku foli për zbatueshmërinë e ligjit, duke theksuar se propozim-rezoluta është pozitive. Gjithashtu z.Dermaku foli edhe për disa ligje tjera përfshirë disa nene të Kushtetutës

Kryetari i dha përgjigje duke theksuar që ky dokuent momentalisht do të jetë referues. Gjithashtu Kryetari e ftoi z.Dermakun për bashkëpunim dhe këshilla në vazhdim të plotësimit të këtij dokumenti gjatë vitit 2026.

- Z. Rasim Mjekiqi foli për ndikimin e inflacionit ndër vite nëse është menduar të merret paraysh, ndërsa.

Kryetari dha sqarime duke theksuar që gjithsesi koeficienti i inflacionit do të jetë pjesë përbërse e këtij dokumenti pas finalizimit të plotë.

Pyetje tjera më nuk pati andaj Kryetari vazhdoi me procedurën e votimit duke kërkuar nga administrata që të konstatoj numrin e anëtarëve prezent.

U konstatua se numri anëtarëve prezent në Kuvend ishte 505.

Pas konstatimit të anëtarëve prezent, Kryetari i hodhi në votim Projekt - Rezolutën.

me 505 vota Për,
2 vota Kundër dhe
3 vota Apstenim

Miratohet “Projekt Rezolutës për miratimin e dokumenteve referuese për kategorizimin e ndërtimit, çmimin mesatar të ndërtimit dhe çmimet minimale referuese të shërbimeve arkitektonike dhe inxhinierike”

Pika 5 – Raportimi i mbikqyrjes së punës së organeve të Odës (për periudhën 1-vjeçare, viti 2025) nga Komisionit Mbikëqyrës, Komisioni Ministrir për Themlimin e Odës (KMTHO)

Kryetari e ftoi z. Xhemail Metolli, Kryesues i Komisionit Mbikqyrës njëherit edhe Kryesues i KMTHO për prezantimin e raportit të mbikqyrjes së punës së organeve të Odë për periudhën 1-vjeçare (2025).

Pas prezantimit, Kryetari e falënderoi z.Metolli për prezantimin dhe mbështetjen ndaj organeve të OIRK-së.

Pika 4. Raporti financiar vjetor i Odës

Më pas, Kryetari e ftoi Drejtorin Ekzekutiv të Odës, z. Lulzim Ismajli, për të njoftuar Kuvendin për raportin financiar vjetor për vitin 2025, si dhe për planifikimin financiar për vitin 2026.

Pas prezantimit, Kryetari pyeti nëse ka pyetje. Nuk pati pyetje nga të anëtarët dhe vazhdoi me pikën tjetër të rendit të ditës.

Pika 8. Të ndryshme (diskutim i hapur)

Kryetarit pyeti anëtarët për diskutime të hapura ose ngritjen e ndonjë qështjeje. Nuk pati të interesuar për diskutime të temave tjera.

Pika 9. Mbyllja e mbledhjes nga Kryetari i OIRK-së.

Në përfundim, Kryetari falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen dhe kontributin e dhënë në punimet e këtij Kuvendi. i njoftoi anëtarët që në ditët në vijim vendimet e nxjerrura nga ky Kuvend do të protokolohen dhe vulosen dhe të njëjtat do të publikohen në sajtin zyrtar të OIRK-së.

Më pastaj Kryetari i shpalli të mbyllura punimet e Kuvendit në orën 18:05.

Kryetari: Arsim Rapuca

Procesmbajtësja: Leonora Muçaj

